

## AKTET E PËRGJISTHEM NËLIGJORE JURIDIKE

Aktet nënligjore juridike miratohen nga organet të cilat në hierarkinë e organeve shtetërore qëndrojnë më poshtë se organi ligjvënës dhe për këtë shkak duhet të jenë në pajtim me ligjin, dhe Kushtetutën. Me aktet e përgjithshme nënligjore juridike nuk mund të krijohen të drejta dhe obligime të reja për qytetarin dhe personat juridik, por vetëm precizohen dhe përpunohen ligjet, respektivisht ato miratohen në bazë të autorizimit që del nga ligji. Aktet nënligjore juridike janë të lidhura mes vete me norma të përgjithshme juridike si pjesë përbërëse e ligjit, dhe nuk mund të krijojnë situata të reja që janë në kundërshtim me ligjin.

Ekzistojnë këto lloje të akteve nënligjore juridike: Urdhëresë - është akti më i rëndësishëm nënligjor juridik. E miratojnë organet ekzekutuese dhe ato administrative në shtet. Më së shpeshti miratohet në mbledhje të Qeverisë. Me ato përpunohen normat ligjore. Dallohen dy lloje urdhëresash: a) Urdhëresë për ekzekutimin e ligjit - miratohet me qëllim të zbatimit të ligjit. Baza e miratimit të saj është klauzola ekzekutive (dispozitë) sipas së cilës trupi ligjvënës e autorizon Qeverinë, ose e urdhëron që të sjell urdhëresë me të cilën në kohë më të shkurtë do të rregullohet ndonjë sferë e përcaktuar me ligj. Kjo dispozitë vlen deri atë herë kurrë do të ekzistojë ligji. b) Urdhëresë me fuqi juridike - me të rregullohen marrëdhëniet që do të duhet të rregullohen me ligj. Miratohet në gjendje të jashtëzakonshme dhe në kushte të luftës. Në Republikën e Maqedonisë e miraton qeveria dhe është e vlefshme për sa zgjat lufta dhe gjendja e jashtëzakonshme. Urdhëri - e miratojnë ministratë. Ju dedikohet personave të pacaktuar që ndodhen në situatë të caktuar. Urdhërohet ose ndalohet ndonjë sjellje e caktuar në situatë të caktuar, e cila është i karakterit të domosdoshëm. (p.sh. urdhri për pastrimin e borës, për evakuimin e popullsisë, orë policore, mobilizim). Rregullore - e miratojnë organet e administratës me qëllim përpunim dhe ekzekutim dispozitave të caktuara ligjore ose rregulltjetër të Kuvendit dhe Qeverisë. E miratojnë ministrat me çka e rregullojnë një çështje shumë të rëndësishme nga kompetenca e tyre. (p.sh. Rregullore për standardet dhe vlerësimet, Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, rregullore për rrogat dhe kompensimet). Me rregullore mund të rregullohet edhe organizimi i brendshëm i punës së ndonjë

organ të caktuar. Udhëzimin - e miratojnë organet administrative dhe ka fuqi më të ulët juridike. Nuk përmban norma juridike, por e përpunon mënyrën e zbatimit të normave juridike që janë të miratuara. Dekretin - e sjell sheç i shtetit dhe mund të jetë: a) Akti i përgjithshëm - dekretim i ligjit b) Akti individual - akt me të cilin sheç i shtetit i emëron diplomatët, personalitetet e larta në sferën e mbrojtjes, jep dekorata etj. Vendimi - është akt i përgjithshëm juridik që në të shpeshtën e rasteve miratohet në nivel të pushtetit lokal dhe me këtë rregullohen çështjet me peshë lokale. E miraton këshilli komunal dhe do të duhet të jetë në përputhje me statutin e komunës. Nga ky fakt statuti i komunës, i cili është akti më i lartë themelor i komunës, dhe paraqet kushtetutë të vogël për komunën në nivel lokal.

? PYETJE: 1. Ç'janë aktet nënligjore të përgjithshme juridike? 2. Numëro aktet nënligjore të përgjithshme juridike? 3. Shpjego dispozitën me fuqi ligjore. 4. Shpjego urdhëresën. 5. Përse miratohen rregulloret? 6. Cili është akti nënligjor juridik më i pavlefshëm? 7. Kush e dekreton ligjin? Si mund të jetë dekreti? 8. Me cilin akt juridik nga hierarkia e akteve juridike barazohet vendimi?

## **NOCIONET DHE LLOJET E AKTEVE TË VEÇANTA JURIDIKE**

Aktet e veçanta juridike përmbajnë norma të veçanta juridike. Ata i rregullojnë dhe zgjedhin situatat konkrete. Bazat e tyre janë aktet e përgjithshme juridike dhe me ta konkretizohen aktet e përgjithshme juridike.

Llojet e akteve të veçanta juridike

Sipas asaj se kushti i miraton aktet e veçanta juridike ato ndahen në: a) akte të veçanta që i miratojnë organet shtetërore; b) akte të veçanta që i miratojnë personat privat dhe paraqiten në formë të veprave juridike (testament, marrëveshje). Aktet e veçanta juridike që i miratojnë organet shtetërore sipas asaj cili organ i miraton ndahen në akte administrative dhe gjyqësore.

? PYETJE: 1. Çka nënkuptojmë me aktin e veçantë juridik? 2. Cilat lloje të akteve të veçanta juridike ekzistojnë?